VENDIM
Nr. 479, datë 25.7.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET NR. 1699, DATË 29.12.2008; NR. 707, DATË 23.6.2009; NR. 784, DATË 1.7.2009; NR. 1147, DATË 25.11.2009; NR. 1231, DATË 11.12.2009; NR. 1259, DATË 23.12.2009; NR. 268, DATË 21.4.2010; NR. 382, DATË 19.5.2010; NR. 714, DATË 25.8.2010; NR. 1015, DATË 10.12.2010; NR. 1069, DATË 29.12.2010; NR. 61, DATË 26.1.2011; NR. 99, DATË 4.2.2011; NR. 135, DATË 23.2.2011; NR. 196, DATË 9.3.2011; NR. 230, DATË 13.3.2011; NR. 297, DATË 14.4.2011; NR. 363, DATË 4.5.2011; NR. 390, DATË 25.5.2011; NR. 457, DATË 22.6.2011; NR. 691, DATË 12.10.2011, DHE NR. 186, DATË 6.3.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR MIRATIMIN E DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Korrigjimin e masës përfundimtare të dëmshpërblimit financiar, të parashikuar në vendimet nr. 1699, datë 29.12.2008; nr. 707, datë 23.6.2009; nr. 784, datë 1.7.2009; nr. 1147, datë 25.11.2009; nr. 1231, datë 11.12.2009; nr. 1259, datë 23.12.2009; nr. 268, datë 21.4.2010; nr. 382, datë 19.5.2010; nr. 714, datë 25.8.2010; nr. 1015, datë 10.12.2010; nr. 1069, datë 29.12.2010; nr. 61, datë 26.1.2011; nr. 99, datë 4.2.2011; nr. 135, datë 23.2.2011; nr. 196, datë 9.3.2011; nr. 230, datë 13.3.2011; nr. 297, datë 14.4.2011; nr. 363, datë 4.5.2011; nr. 390, datë 25.5.2011; nr. 457, datë 22.6.2011; nr. 691, datë 12.10.2011, dhe nr. 186, datë 6.3.2012 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, sipas anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha